



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.07.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë viti 2019-2020”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
8. *Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Erton Karagjozi, EURALIUS.*
10. *Rezart Alija, EURALIUS.*
11. *Helios Reveli, EURALIUS.*
12. *Migena Kondo, KSHH.*
13. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
14. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
15. *Klodian Rado, EURALIUS.*
16. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
17. *Erjon Fejzulla, USAID.*
18. *Anne M. Trice, USAID.*
19. *Julinda Karaboja, USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë viti 2019-2020”.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit që jeni prezent në mbledhjen e datës 19 korrik 2019. Të gjithë anëtarët janë prezent në këtë mbledhje.

Sikurse jeni në dijeni, në këtë mbledhje janë për t'u diskutuar 5 çështje kryesore.

Çështja e parë është çështja e shqyrtimit të projektvendimit “Për miratimin e planit strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, viti 2019-2020”.

Çështja e dytë është shqyrtimi i projektvendimeve “Për emërimin e gjyqtarëve magjistratë që janë konkretisht për emërimin e gjyqtarës znj. {...}, të znj. {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.”

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për disa shtesa në vendimin nr. 7, datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave””, i përgatitur kjo nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Çështja e katërt, është shqyrtimi i projektvendimit “Mbi procedurën e transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Dhe çështja e pestë është “Caktimi i gjyqtarëve në gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.

Atëherë nëse ju nuk keni ndonjë koment dhe sugjerim për rendin e ditës, unë po kaloj tek shqyrtimi i pikës së parë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me “Miratimin e planit strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për vitin 2009-2020”.

Atëherë, në cilësinë e kryetares së Komisionit për Planifikimin Strategjik dhe Buxhetit, unë po relatoj, le të themi projekt-aktin, dokumentin mjaft të rëndësishëm që Këshilli sot do të marrë në shqyrtim dhe do të miratojë. Unë jam e bindur që ky është një nga dokumentet më të rëndësishëm që ne po miratojmë, krahas shumë akteve të tjera nënligjore dhe është një dokument i cili si shumë dokumente të tjerë i është nënshtruar një konsultimi shumë të mirë me të gjithë aktorët e mundshëm.

Atëherë, pa humbur kohë po filloj relatimin e projekt-aktit.

Sikurse jeni në dijëni të kuadrit ligjor, bazuar në nenin 81, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, harton, miraton dhe zbaton një plan strategjik për sistemin gjyqësor. Duke mbajtur parasysh rëndësinë e hartimit të këtij dokumenti si një udhërrëfyes i veprimtarisë së KLGJ-së dhe i vetë sistemit gjyqësor, legjislatori ka parashikuar koordinimin e këtij dokumenti me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SNSD). Përveç detyrimeve të mësipërme ky nen (pra neni 81 i ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”) përcakton qartë dhe elementët e domosdoshëm që duhet të përmbajë plani strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht, ai duhet:

- a) të përcaktojë misionin dhe vlerat kryesore të gjyqësorit;
- b) të analizojë profilin e gjyqësorit;
- c) të caktojë çështje strategjike;
- ç) të përcaktojë prioritetet;
- d) të përcaktojë monitorimin, kuadrin vlerësues dhe raportues për strategjinë.

Në pikën 3 të nenit 81, gjithashtu kërkohet që plani strategjik të shoqërohet me një plan veprimi, i cili përfshin objektivat operacionale, veprimtaritë, faturën financiare, si dhe treguesit e matjes së arritjeve.

Gjatë hartimit të dokumentit strategjik është mbajtur parasysh harmonizimi dhe përputhja me kuadrin nënligjor, konkretisht Urdhrin nr. 93, datë 07.08.2012 i cili përcakton strukturën dhe elementët e domosdoshëm që duhet të përmbajnë strategjitë sektoriale dhe ndër-sektoriale në Republikën e Shqipërisë. Dokumente të tjerë referues të konsultuar përfshijnë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2017-2020, Strategjinë e Reformës në Administratën Publike, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e Veprimit 2019-2021. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë aspiratat e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian është parë e domosdoshme edhe konsultimi i dokumenteve të tillë si Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, Progres-raporti i BE-së për Shqipërinë 2018, Instrumenti i Asistencës së Para - anëtarësimit (IPA II) 2014-2020, si mjete me të cilat BE-ja mbështet reformat e shtetit shqiptar me anë të ndihmës financiare dhe asaj teknike.

Hartimi i këtij Plani Strategjik shkon përtej detyrimit ligjor. Ai është një instrument planifikimi i cili synon të prioritzojë objektivat, sistematizojë veprimet në të cilat duhet të investohet Këshilli, duke maksimizuar burimet financiare dhe njerëzore, si dhe duke adresuar strategjikisht problemet dhe nevojat më akute të gjykatave. Kjo strategji shoqërohet me një Plan Veprimi i cili zbërthen objektivat në masa dhe nisma konkrete, duke synuar arritjen e rezultate të dëshiruara dhe të matshme për të gjithë sistemin gjyqësor.

Plani aktual është parashikuar për vitet 2019-2020, si një plan i parë i cili përkon me konstituimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor si qeverisja e re e sistemit gjyqësor, duke reflektuar kompetencat e zgjeruara të këtij të fundit dhe trajtuar me prioritet nevojat emergjente të sistemit gjyqësor të trashëguara nga funksionimi i ish-KLD-së në periudhë tranzicioni, apo vakancave të krijuara rishtazi si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Në këtë frymë Plani Strategjik paraqet vizionin dhe vlerat në të cilat mbështetet KLGJ-ja në përmbushje të misionit të saj për ndërtimin, udhëheqjen dhe qeverisjen e një gjyqësori me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut.

Pesë janë shtyllat përcaktuese të drejtimit të kësaj strategjie:

Synimi i parë është: Përshpejtimi i reformës së pushtetit gjyqësor dhe akordimi i burimeve.

Synimi i dytë është: Përcaktimi dhe zbatimi i standardeve për ekselencë gjyqësore.

Synimi i tretë: Ofrimi efikas i shërbimeve dhe funksionimi më i mirë i gjykatave.

Synimi i katërt ka të bëjë me: Zhvillimi i kapaciteteve të brendshme të KLGJ-së.

Synimi i pestë : Hartimi i strategjive të efektshme për komunikimin e jashtëm.

Këto synime zbërthehen më tej në tabelën e Plan Veprimit në objektiva dhe masa konkrete, duke përcaktuar qartësisht njësitë zbatuese, indikatorët matës cilësorë dhe sasiorë për vlerësimin e rezultateve në një hark kohor të përcaktuar.

Dy elementë të rëndësishëm që Plani Strategjik dhe ai i Veprimit parashikojnë janë:

1. Mënyra e monitorimit të zbatimit të vetë planit, duke parashikuar strukturën përgjegjëse zbatuese, raportimin periodik për progresin e arritur, dhe mekanizmin e rishikimit dhe transparencës ndaj publikut.

2. Parashikimi buxhetor i cili përcakton mundësitë objektive për realizimin e planit (objektivave) dhe evidenton mungesat financiare të cilat kërkojnë financim në të ardhmen. Sipas një parashikimi financiar i cili përcakton në mënyrë të detajuar llojin e shpenzimeve (personeli, operative dhe kapitale), e parë përkundrejt burimeve të alokuara, është evidentuar se aktualisht rreth 50% e nismave mbulohen nga buxheti i shtetit. Për pjesën e pambuluar me fonde publike parashikohet një konsultim me partnerët ndërkombëtarë.

Atë që unë dua të ndaloj ka të bëjë lidhur me procesin e hartimit të këtij plani. Këto dy dokumenta strategjike janë punuar në një hark kohor shumë të shkurtër shkurt-korrik 2019.

Përmbajtja e këtyre dokumenteve i është nënshtruar një procesi të kujdesshëm hartimi dhe konsultimi, këtu përfshihen jo vetëm anëtarët e Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, por të gjithë anëtarët e Këshillit si pjesë integrale e këtij procesi.

Për t'u siguruar mbi koherencën, vlefshmërinë, dhe përfaqësimin e këtyre dokumenteve strategjike, ato i janë nënshtruar disa konsultimeve të tjera si ai brenda sistemit gjyqësor ashtu edhe jashtë tij, për të arritur në këtë draft të konsoliduar.

Fazat e konsultimit – Siç jeni në dijeni, konkretisht më datë 3 qershor 2019, u organizua konsultimi i parë i draft-planit strategjik dhe atij të veprimit me të gjithë drejtuesit e gjykatave.

Konsultimi i dytë, u krye më datë 25 qershor 2019 me rreth 15 përfaqësues të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e drejtësisë dhe që mbrojnë të drejtat e grupeve në nevojë.

Konsultimi i tretë, si pjesë e detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 71, pika 5, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i cili përcakton shprehimisht bashkëpunimin e KLGJ-së me Ministrin e Drejtësisë ...“për të siguruar përputhjen e planeve strategjike dhe buxhetore të sistemit gjyqësor me politikat shtetërore dhe SNSD-

në”, u krye më datë 8 korrik 2019. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, me shkresën nr. 5343 prot., Ministria e Drejtësisë përcolli disa sugjerime dhe komente mbi dokumentet e sipërpërmendura me qëllim bashkërendimin e masave dhe zbatimin efikas të reformës në drejtësi. Këto komente janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar plotësisht në draftin e prezantuar.

Së fundmi, vlen të theksohet se të dy dokumentet strategjikë janë hartuar me mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme disamujore të ekspertëve të projektit “Drejtësi për të Gjithë” të USAID, të cilët i kanë dhënë vlerë të shtuar të gjitha përpjekjeve tona të deritanishme për të ngritur një sistem gjyqësor të pavarur, efikas dhe që gëzon besimin e publikut.

Sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Miratimin e Projektvendimit “Për Planin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (2019-2020)”. Faleminderit!

Nëse juve keni ndonjë diskutim, apo sugjerim...

Po, zoti...!

Medi Bici: Meqenëse unë jam njëri ndër anëtarët e Komisionit të Strategjisë nuk kam ndonjë gjë të veçantë për Planin Strategjik, por do të them nja dy gjëra të përgjithshme. Ky ishte plani i parë strategjik i parashikuar dhe në ligj dhe i përgatitur pas një pune të gjatë të Komisionit dhe të gjithë anëtarëve të Këshillit, përfshirë këtu dhe të disa kryetarëve të gjykatave. Por një ndihmë të pakursyer në këtë drejtim na ka dhënë dhe Misioni “Drejtësi për të Gjithë”, duke filluar me zonjën {...}, specialisti {...} dhe të dy specialistët e tjerë shqiptarë znj. Valbon dhe z. Erjon, të cilën unë i falënderoj shumë edhe për debatet që kemi bërë, ndoshta kemi patur debate në konceptet e reja, që tani janë përfshirë dhe janë bërë pjesë e planit strategjik, siç ka qenë ‘drejtësia ekselente’ ose ‘kaskada’, dhe ne mendojmë që kjo do të jetë një rrugë shumë e mirë për planin tjetër, sepse në Shqipëri ka pasur përvojë për planet, nuk quheshin strategjike, kanë qenë plane në fushën ekonomike, bile ato kanë qenë dhe të monitoruara shumë mirë, por ky është plani i parë për sa i përket sistemit të drejtësisë. Kështu që unë falënderoj të gjithë

kolegët, përveç Komisionit që e kishim për detyrë, dhe të gjithë pjesëtarët e të dy misionëve.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Ndonjë? Po!

Fatmira Luli: Shkurtimisht edhe unë si anëtare e Komisionit po i them dy fjalë lidhur me punën e bërë për hartimin dhe miratimin e këtij Plani Strategjik. Falënderoj tërë kolegët dhe ekspertët të cilët na mbështetën me ditë të tëra në diskutimet tona në debatet tona për përmirësimin e këtij plani. Besoj që ka dalë një plan i mirë strategjik që drejton mirë nevojat që ka institucioni ynë i ri në këtë periudhë tranzitore. Janë përcaktuar qartë drejtimi nga do shkojë institucioni, afatet kohore, buxhetimi, të tërë hapat e nevojshme që duhet të hedhim të sigurt, për reformën në drejtësi, e cila i është ngarkuar institucionit tonë me ndryshimet legjislative. Për këtë arsye, falënderoj të gjithë, ekspertët e USAID-it, falënderoj kolegët për punën e madhe që bën për hartimin dhe miratimin e këtij plani. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

E do fjalën ndonjë person tjetër?

Atëherë kalojmë në votimin e planit tonë strategjik?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi miratimin e Planit Strategjik, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për vitin 2019-2020, sipas

tekstit të bashkëlidhur, të propozuar nga Komisioni i Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit, dhe ky vendim hyn në fuqi ditën e votimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.07.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve:

1. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
2. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
3. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
4. “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”;
5. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
6. “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”;
7. “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”;
8. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
9. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
10. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 8. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 9. Erton Karagjozi, EURALIUS.**
- 10. Rezart Alija, EURALIUS.**
- 11. Helios Reveli, EURALIUS.**
- 12. Migena Kondo, KSHH.**
- 13. Klara Kodra, Qendra Evropiane.**
- 14. Gregor Borgowski, EURALIUS.**
- 15. Klodian Rado, EURALIUS.**
- 16. Valbona Bala (Pajo), USAID.**
- 17. Erjon Fejzulla, USAID.**
- 18. Anne M. Trice, USAID.**

29. Julinda Karaboja, USAID.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve:

1. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
2. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
3. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
4. “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”;
5. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
6. “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”;
7. “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”;
8. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
9. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”;
10. “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”.

Naureda Llagami: Vazhdojmë me çështjen e dytë, sipas rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për emërimin e gjyqtarëve. Lidhur me relatimin e këtyre projekt-akteve, fjalën po ia kaloj kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, z. Toska.

Ilir Toska: Atëherë, secili nga aktet e emërimit është përgatitur nga relatori që ka pasur çështjen për verifikimin e kriterëve ligjore. Projektvendimi i parë është për znj. {...}, që i përket relatores znj. Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit!

Atëherë Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi përfundoi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtare të kandidatës {...}, sipas vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, në mbledhjen e datës 15.07.2019, me vendimin nr.

116, pasi konkludoi se për kandidaten {...} nuk ka të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare, u vendos kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”, sipas të cilit, kandidatja {...}, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017-2018, emërohet “gjyqtare”, duke konkluduar se ajo plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këto kushte, duke qenë se Komisioni ka konkluduar se znj. {...}, pas kualifikimit të saj, plotëson kushtet dhe kriteret ligjore për t’u emëruar gjyqtare, vendos, propozon që bazuar në nenin 136/a të Kushtetutës dhe në nenin 35 të ligjit nr.96/2016, t’i propozojë Këshilli të Lartë Gjyqësor të emërojë si gjyqtare znj. {...}.

Naureda Llagami: Atëherë, nëse s’keni komente lidhur me propozimin e bërë nga relatorja, kalojmë në votimin e projekt-aktit për emërimin e znj. {...}?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar znj. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vazhdojmë me projekt-aktin e dytë, i cili ka të bëjë “Për emërimin gjyqtare. Të znj. {...}”. Fjalën ia jap relatorit të çështjes. Po, zonja Marçela.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Edhe për kandidaten {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 117, datë 15.07.2019, pasi ka konkluduar se nuk ka shkaqe të cilat mund të sjellin shkualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtare të kësaj kandidateje, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në këto kushte, në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, edhe për këtë kandidate, ka hartuar projektvendimin përkatës, duke i propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, që kandidatja, znj. {...}, të emërohet gjyqtare, bazuar në nenin 136/a të Kushtetutës dhe në nenin 35 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin e propozimit të relatores?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, që ka të bëjë me emërimin gjyqtare së znj. {...}. Edhe për këtë projekt-akt do të relatojë relatorja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit!

Edhe për kandidaten {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konkluduar me vendimin nr. 118, datë 15.07.2019, duke vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së

emërimit duke konkluduar që nuk ka shkaqe të cilat do të çonin në shkualifikimin e kësaj kandidateje.

Në vijim të procedurës së emërimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi ka konstatuar se kandidatja {...} plotëson kushtet për t'u emëruar gjyqtare, në përputhje me nenin 136/a të Kushtetutës dhe nenin 35 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", çmon t'i propozojë Këshillit të Lartë Gjyqësor që edhe kandidatja {...} të emërohet gjyqtare. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, znj. Shehu!

Atëherë kalojmë në votimin e projekt propozimit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me shqyrtimin e projektvendimit tjetër për emërimin si gjyqtar të z. {...}, relatimi i të cilit do të bëhet serish nga znj. Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Edhe për kandidatin {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka arritur në të njëjtin konkluzion, sikurse dhe për tre kandidatet e mëparshme. Pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 119, datë 15.07.2019, ka vendosur të kualifikojë këtë kandidat dhe të vijojë procedurën e emërimit të tij.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konstaton se kandidati plotëson kushtet dhe kriteret ligjore për t'u emëruar gjyqtar, bazuar në nenin 35 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" si dhe në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që kandidati, z. {...} të emërohet gjyqtar.

Naureda Llagami: Faleminderit, znj. Shehu!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në miratimin e projekt-aktit tjetër, lidhur me emërimin si gjyqtar të znj. {...}. Relator i këtij projekt-akti është z. Illir Toska.

Illir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Zonja {...} është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2017-2018. Për këtë shkak, referuar ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenet 32 dhe 35 të tij, si dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së

Lartë”, u zhvilluan procedurat e verifikimit për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të emërimit të saj si gjyqtare, ku në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 120, datë 15.07.2019, vendosi kualifikimin e znj. {...} për t’u emëruar si gjyqtare dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në këto kushte, ndërsa zonja {...} përmbush kushtet dhe kriteret ligjore për emërim si gjyqtare, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 35, të ligjit nr. 96 të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor emërimin gjyqtar, të znj. {...}. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatori?

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk është regjistruar.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar znj. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me shqyrtimin e projekt-aktit tjetër, i cili ka të bëjë me emërimin gjyqtar të z. {...}. Edhe për këtë projekt-akt, relator do jetë zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, zoti {...} është diplomuar edhe ai në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017-2018 dhe për këtë shkak, bazuar në nenin 32 dhe 35 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në

vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit të zotit {...} si gjyqtar, ku në përfundim, me vendimin nr. 121, datë 15.07.2019, vendosi kualifikimin e tij për t'u emëruar si gjyqtar dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në këto kushte, ndërsa zoti {...} përmbush kushtet dhe kriteret ligjore për t'u emëruar si gjyqtar, bazuar në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit emërimin gjyqtar, të zotit {...}. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

E hedhim në votim projekt-aktin e propozuar nga relatori?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me shqyrtimin e projekt-aktit të radhës, që është për emërimin gjyqtar të z. {...}, relator i të cilit është z. Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, me propozim të Komisionit është

miratuar vendimi nr. 122, datë 15.07.2019 me të cilin është konkluduar se kandidati {...} nuk ka të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin nga kandidimi për emërimin si gjyqtar, duke u vendosur edhe kualifikimi i tij dhe vijimi i procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, kandidati {...}, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017-2018, emërohet “gjyqtar”, ndërsa ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për rrjedhojë, Komisioni ka përgatitur projektvendimin përkatës, duke propozuar emërimin e kandidatit {...} si gjyqtar dhe njëkohësisht edhe afatin se kur ky akt hyn në fuqi, që përkon me publikimin në faqen zyrtare të internetit.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin e propozuar nga relatori?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me shqyrtimin e projekt-aktit të radhës, që ka të bëjë me emërimin gjyqtare të zonjës {...}, për të cilën relator është sërish zoti Toro.

Alban Toro: Po! Faleminderit!

Edhe për kandidaten {...}, janë kryer të njëjtat procedura verifikimi, konform ligjit dhe në përfundim, me vendimin nr. 123, datë 15.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u konkludua se kjo kandidate nuk ka të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin nga kandidimi për emërimin si gjyqtare dhe Këshilli vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të emërimit.

Në vijim të këtyre procedurave, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi konstatoi që kandidatja {...}, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017-2018 plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit, ka propozuar emërimin e saj si gjyqtare. Natyrisht, në pjesën e redaktuar është edhe hyrja në fuqi e aktit, e cila përkon me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar nga zoti Toro?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me shqyrtimin e projekt-aktit tjetër, që ka të bëjë me emërimin gjyqtare të zonjës {...}. Edhe për këtë projekt-akt, relator do të jetë z. Toro.

Alban Toro: Edhe për kandidaten {...} janë kryer të njëjtat procedura verifikimi, në përfundim të së cilës Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin 124, datë 15.07.2019

konkludoj se për të nuk ka të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin e kandidimit për emërimin si gjyqtar dhe vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni, pasi konstatoi që kandidatja {...} e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017-2018 plotësonte kushtet edhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit 96/2016, ka propozuar emërimin e saj si gjyqtare, natyrisht duke përfshirë në aktin individual edhe hyrjen në fuqi të këtij akti, që përkon me datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë për votimin propozimin e bërë nga relatori?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë edhe në shqyrtimin e projekt-aktit për emërimin gjyqtare të znj. {...}. Relatori i këtij projekt-akti është sërish zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Edhe për kandidaten {...} janë kryer të njëjtat procedura verifikimi, në përfundim të së cilës, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstatoi me vendimin 125, datë 15.07.2019, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të emërimit. Në vijim të kësaj procedure, në kushtet kur kandidatja {...} plotësonte kushtet dhe kriteret e emërimit sipas

nenit 136/a të Kushtetutës të Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit 96/2016, Komisioni propozoi emërimin e saj gjyqtare.

Sipas pikës 2 të projektvendimit parashikohet që një kopje e këtij vendimi duhet t'i njoftohet gjyqtares dhe njëkohësisht është përcaktuar dhe momenti i hyrjes në fuqi që përkon me datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë projekt-aktin për votim sipas propozimit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.07.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa shtesa në vendimin nr.7, datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave””, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 8. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Erton Karagjozi, EURALIUS.*
- 10. Rezart Alija, EURALIUS.*
- 11. Helios Reveli, EURALIUS.*
- 12. Migena Kondo, KSHH.*
- 13. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 14. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 15. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 16. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 17. Erjon Fejzulla, USAID.*
- 18. Anne M. Trice, USAID.*
- 29. Julinda Karaboja, USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa shtesa në vendimin nr.7, datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Atëherë, sipas rendit të ditës, kalojmë në shqyrtimin e projekt-aktit tjetër, i cili ka të bëjë me disa shtesa vendimin nr.7, datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka të bëjë me rregulloren “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe që do relatohet nga kryetarja e këtij Komisioni, zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, Kryetare!

Sikurse jemi të gjithë në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efikasitetit, jo vetëm në ushtrim të veprimtarisë gjyqësore por edhe në atë të administrimit gjyqësor, që në momentin pas konstituimit të tij, në ushtrim të kompetencave që kanë lidhje me administrimin e sistemit gjyqësor, në zbatim të ligjit nr.115/2016, nr.96/2016 dhe të nenit 26, pika 6 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar vendimin nr.7, datë 21.12.2018 “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”. Ky vendim ka përcaktuar rregulla të hollësishme për organizimin e mbledhjes së gjyqtarëve dhe të gjithë procesit të zgjedhjes së zëvendëskryetarit të gjykatës, ndërkohë që kriteret bazë për zgjedhjen, si vjetërsia në punë dhe përvoja profesionale, sikundër edhe rastet e zëvendësimit të zëvendëskryetarit janë të përcaktuara në ligj.

Në zbatim të këtij vendimi, sikundër keni edhe të gjithë informacionin bashkëngjitur praktikës, në të gjitha Gjykatat e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykatës së Lartë, janë zhvilluar zgjedhjet për zëvendëskryetarin e gjykatës, rezultatet e të cilave i janë komunikuar edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me Dekretin nr.7818, datë 16.11.2012, i cili vazhdon të jetë ende në fuqi, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është përcaktuar me 4 gjyqtarë, por faktikisht, në përbërje të saj, ka pasur vetëm dy gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përhershme, zonja {...} e zgjedhur si kryetare e gjykatës dhe zoti {...}. Të dy këta gjyqtarë aktualisht janë të pezulluar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Aktualisht, për shkak të procesit të rivlerësimit, në këtë gjykatë ka mbetur vetëm 1 gjyqtar, i cili është zoti {...}, i caktuar në mënyrë të përkohshme, i transferuar përkohësisht, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, afati i transferimit të të cilit, sipas vendimmarrjes së fundit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbaron më datë 15.09.2019. Ndodhur në këto rrethana, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër nuk ka gjyqtar në funksionin e kryetarit, nuk ka të zgjedhur një zëvendëskryetar, dhe për shkak se thirrja e mbledhjes së gjyqtarëve ka qenë objektivisht e pamundur, ashtu sikurse ende nuk ka të krijuar një Këshill Gjykatë, për drejtimin dhe organizimin e mbarëvajtjes së punës.

Në pikën 7 të vendimit nr. 71, datë 20.05.2019, akti i nxjerrë nga Këshillit të Lartë Gjyqësor... bëhet fjalë për pikën 7 të vendimit 21.12.2018, akti i nxjerrë nga Këshillit të Lartë Gjyqësor në zbatim të nenit 26/6 e ligjit, parashikohet: “Kur numri i gjyqtarëve të gjykatës është 2, votimi nuk kryhet dhe gjyqtari që nuk është kryetar, konsiderohet automatikisht si zëvendëskryetar. Në rast se asnjëri nga të dy gjyqtarët nuk është kryetar, përsëri votimi nuk kryhet dhe konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar. Në rast se ky i fundit refuzon, gjyqtari tjetër konsiderohet si zgjedhur si zëvendëskryetar. Në çdo rast, kancelari i gjykatës dokumenton për zgjedhjen.”

Ky parashikim i konceptuar në vendim si një dispozitë tranzitore nuk arrin që të rregullojë aktualisht të gjitha situatat faktike të krijuara në gjykata, në kushtet kur parashikon vetëm mënyrën se si zgjidhet zëvendëskryetari kur në gjykatë ka vetëm dy gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përhershme. Pra ata janë gjyqtarë të së njëjtës gjykatë.

Për sa më sipër, është parë e nevojshme të ndërhyhet me anë të një dispozite shtesë në vendimin nr. 7, datë 21.12.2018 Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”, me këtë parashikim: “2. Kur asnjë prej gjyqtarëve në detyrë nuk plotëson kriteret për t’u zgjedhur zëvendëskryetar apo zgjedhja e tij nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës është objektivisht e pamundur, konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar, gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë”. Kjo përfaqëson një dispozitë shtesë tranzitore për zgjedhjen e situatave të tilla, kur asnjë prej gjyqtarëve të gjykatës nuk plotëson kriteret për t’u zgjedhur si zëvendëskryetar, por që

për efekt të administrimit të gjykatës është i domosdoshëm, bashkë me situatën ku mbledhja e gjyqtarëve është e pamundur objektivisht të zgjedhë zëvendëskryetarin.

Kriteri i gjyqtarit me përvojën profesionale më të gjatë, i përzgjedhur për të aplikuar në rastin konkret, përmendet në nenin 26 të ligjit 98/2016 si mekanizëm zhblllokues i situatës, duke i dhënë përparësi atij në rast barazie të votave, pra i jepet përparësi gjyqtarit me përvojën profesionale më të gjatë.

Në disa dispozita të tjera të ligjit, për çështjet e administrimit të gjykatës ... përsëri gjyqtarëve me përvojën profesionale më të gjatë. I njëjti kriter është mbajtur parasysht dhe në rastin e zëvendësimit të anëtarëve të Këshillave të Gjykatave në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Prandaj edhe Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në këtë shtesë të paraqitur si propozim për miratim, ka përzgjedhur këtë kriter për të zgjidhur problematikën jo vetëm aktuale të shfaqur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, por edhe ato që mund të shfaqen gjatë kësaj periudhe tranzitore deri në miratimin e hartës së re gjyqësore ose së paku, në plotësimin e gjykatave sipas organikave aktuale, me qëllimin e vetëm të plotësimit të përgjegjësisë dhe detyrimit kushtetues për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, jo vetëm nëpërmjet ushtrimit të funksioneve gjyqësore por edhe atyre që lidhen me administrimin gjyqësor, që janë po aq shumë të rëndësishme.

Ky ishte propozimi

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim, koment mbi projekt-aktin e propozuar, - ndryshimin?

Po, zoti Bici!

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Më vjen mirë që Komisioni i ka reflektuar mendimet tona që dhamë diskutim sepse ashtu siç ishte sjellë projekt-akti, mendoj që zgjidhte vetëm problemin e gjykatave me 4 anëtarë dhe bënte një farë interference në ligj, që nuk është në misionin e vendimeve dhe të rregulloreve, që si akte nënligjore, ato janë për të plotësuar ligjin. Por kam mendimin që edhe pjesa e dytë e propozimit duhet të rregullohet sepse po ta lexosh,

të jep përshtypjen që mbledhja është bërë, mbledhja pra është mbledhur - në fakt mbledhja nuk mund të bëhet nëse në një gjykatë me 7 gjyqtarë, nuk janë 4 gjyqtarë - ose kriteret janë plotësuar. Prandaj mendoj që pas presjes, togfjalëshi “konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë”, duhet vënë kjo shprehje, pra: “...detyra e zëvendëskryetarit do të kryhet nga gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë”. Këtë sugjerim kam për Këshillin. Do të ishte më drejtë të ishte ky për sugjerim.

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Pse është përdorur kjo shprehje? – Sepse në fakt, me zotin Medi bie dakord me të njëjtin parim që, duhet të jetë gjyqtari në gjykatë me përvojën profesionale më të gjatë. Sepse zgjedhja e zëvendëskryetarit nuk është atribut i Këshillit, është atribut i mbledhjes së gjyqtarëve, prandaj është përdorur emërtimi ose togfjalëshi “konsiderohet i zgjedhur”, sepse në fakt është një detyrë që duhet ta bëjë mbledhja e gjyqtarëve. Në qoftë se do të shkruanim që detyrën si zëvendëskryetar duhet ta kryejë një gjyqtar i caktuar, atëherë në këtë rast ia çon atributet Këshillit sepse e kthejmë në një parashikim sikur është detyrim i Këshillit që ta përcaktojë Zëvendëskryetarin. Prandaj është përdorur togfjalëshi “konsiderohet i zgjedhur”. Në fakt është mënyrë e të ndërtuarit të fjalisë së përdorur edhe nga ligji, kur thotë që kur ka barazi të votave midis personave që kandidojnë për zëvendëskryetar, konsiderohet i zgjedhur ai që ka përvojën profesionale më të gjatë. Kjo është arsyeja pse është formuluar në këtë mënyrë fjalia.

Medi Bici: Në këtë rast, mbledhja është bërë. Është bërë mbledhja. Kurse tani mbledhja nuk bëhet, për dy arsye: o për shkak se nuk ka kuorum mbledhja ose për shkak se kandidati për nënkryetar nuk i plotëson cilësitë.

Brikena Ukperaj: Është i njëjti parashikim si pika 1 e nenit 7, i njëjti parashikim si neni 2.

Naureda Llagami: Atëherë, e kalojmë në votim propozimin e bërë nga zoti Medi Bici, duke ndryshuar togfjalëshin “konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar” me “të kryejë detyrën e...”.

Si ishte propozimi konkret? -“...të kryejë detyrën e zëvendëskryetarit...”?

Medi Bici: Po! “Konsiderohet i zgjedhur zëvendëskryetar, detyra e zëvendëskryetarit të kryhet nga gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë”.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë për ndryshim nga zoti Bici dhe më pas atë të Komisionit.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Illir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Kundër.

Kalojmë në votim propozimin e bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Pro.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e një shtese në vendimin nr. 7, datë 21.12.2018 të rregullores “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”, duke shtuar pas pikës 1 të nenit 7, pikën 2 me përmbajtje si më poshtë: “2.

Kur asnjë prej gjyqtarëve në detyrë nuk plotëson kriteret për t'u zgjedhur zëvendëskryetar apo zgjedhja e tij nga Mbledhja e Gjyqtarëve të gjykatës është objektivisht e pamundur, konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar, gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë". Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.07.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 8. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Erton Karagjozi, EURALIUS.*
- 10. Rezart Alija, EURALIUS.*
- 11. Helios Reveli, EURALIUS.*
- 12. Migena Kondo, KSHH.*
- 13. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 14. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 15. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 16. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 17. Erjon Fejzulla, USAID.*
- 18. Anne M. Trice, USAID.*
- 29. Julinda Karaboja, USAID.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në shqyrtimin e projekt-aktit sipas rendin të ditës që ka të bëjë me fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicionit të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Projekt-akt i cili është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe që do të relatohet nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Aktualisht, gjendja e Gjykatës Administrative Shkodër paraqitet tejet serioze.

Më lejoni që në mënyrë retrospektive të paraqesim se me Dekretin nr.7818, datë 16.11.2012, organika e kësaj gjykate, pra e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër është përcaktuar me 4 gjyqtarë. Në përbërje të saj kanë qenë dy gjyqtarë në mënyrë të përhershme ish-kryetarja {...} dhe z. {...}.

Ndërkohë më pas, me dy vendime të veçanta, respektivisht 47, datë 13.06.2018 dhe 99, 21.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në të (pra në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër) është transferuar përkohësisht gjyqtari {...}, afati i transferimit të të cilit më tej është zgjatur në 15.09.2019.

Ndërkohë ka pasur zhvillime të tjera, pasi me dy vendime të veçanta të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, respektivisht 67, 05.10.2018 dhe 04.07.2019, të KPK, janë shkarkuar z. {...} (gjyqtar) dhe ish-kryetarja {...}.

Në kuptim të nenit 62, të dy gjyqtarët, për shkak të ligjit, pozicionet e tyre konsiderohen përkohësisht të lira, për shkak se ata kanë paraqitur ankim pranë KPA-së.

Aktualisht pas vendimmarrjeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në këtë gjykatë, ka mbetur vetëm një gjyqtar, që është transferuar përkohësisht, z. {...}, afati i transferimit i të cilit, siç thashë më lart, është 15.09.2019.

Ndërkohë, të dhënat që vijnë nga kjo gjykatë, për periudhën prill-qershor 2019 paraqiten aktualisht në 945 çështje që po t'i shtojmë edhe muajt që kanë kaluar, besoj që e kanë kaluar edhe këtë numër, pra është një numër relativisht i madh.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura, Komisioni vlerëson se nevojat për delegime të paraqitura nga kjo gjykatë, nuk mund të plotësohen nëpërmjet skemës së delegimit, sipas vendimit nr. 22, 07.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe

procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pasi në skemën e delegimit nuk ka asnjë gjyqtar të disponueshëm.

Gjithashtu Komisioni vlerëson se nuk mund të plotësohen as nëpërmjet përcaktimeve të vendimit nr. 30, 14.02.2019 “Mbi miratimin e vendimit për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në pikën 2 të këtij vendimi parashikohet se: “Ky vendim aplikohet në rast të pamundësisë së zbatimit të neneve 45 dhe 46 të ligjit nr.96/2016.

Për rrjedhim, Komisioni ka vlerësuar, se në rastin konkret, për plotësimin e nevojave të paraqitura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, Këshilli duhet të orientohet në përcaktimet e vendimit nr. 23, 07.02.2019, i cili flet për rregullat për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke shpallur një pozicion të lirë të përkohshëm për transferim pranë kësaj gjykate, duke u bazuar në faktin e parashtruar më sipër, që nuk ka gjyqtarë të disponueshëm në skemën e delegimit si dhe duke vlerësuar që nuk mund të zbatohen parashikimet e vendimit për caktimin e gjyqtarit për një çështje të veçantë, i cili në çdo rast aplikohet në pamundësi të aplikimit të neneve 45 dhe 46 të ligjit për Statusin.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në vendimet e sipërcituara të KLGJ-së, Komisioni vlerëson se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër konsiderohet “Gjykatë në nevojë”.

Neni 3 i rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm e definojnë “Gjykatë në nevojë” dhe nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj.”

Në rastin konkret, rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, ka dy pozicione të lira të përkohshme dhe aktualisht është cenuar rëndë funksionimi normal i saj, marrë në konsideratë jo vetëm organikën aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, Komisioni vlerëson se duhet të nisë procedurat për transferimin e përkohshëm të një gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Komisioni propozon fillimin e procedurave për transferimin e përkohshëm vetëm për një pozicion të lirë të përkohshëm, duke mbajtur në konsideratë për këtë se Këshilli është përpara

ndjekjes së procedurave të emërimit dhe caktimit të të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2018 dhe 2019.

Në vendimin 86, 11.06.2019, konkretisht në nenin 5 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”” është parashikuar ndër të tjera se: “Kur një gjykatë është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka gjyqtar të disponueshëm, me kërkesë të gjykatës në nevojë ose kryesisht, kur vlerëson se nevoja e gjykatës ekziston dhe plotësimi i saj mund të bëhet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm që është i hapur për transferim dhe u bën thirrje gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin. Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave. Thirrja përmban kriteret e transferimit të përkohshëm sipas rastit në fjalë dhe modelin e dhënies së pëlqimit sipas modelit bashkëlidhur kësaj Rregulloreje. Këshilli autorizon Komisionin e Zhvillimit të Karrierës të ndjekë hapat e mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.”

Nga interpretimi i këtyre dispozitave, rezulton se për çdo pozicion të lirë të përkohshëm, me qëllim kryerjen e transferimit, duhet të kërkohet pëlqimi i të gjithë gjyqtarëve që plotësojnë kriteret për të.

Për sa më sipër, Komisioni propozon: Të shpallë një pozicion të lirë të përkohshëm për transferim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër; Të autorizojë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës të ndjekë hapat e mëtejshëm lidhur me procedurën e transferimit të përkohshëm me dhe pa pëlqim të gjyqtarit, bazuar në përcaktimet e vendimit nr. 23, 07.02.2019; Të kërkojë pëlqimin e të gjithë gjyqtarëve të shkallës së parë që përmbushin kriteret për këtë pozicion.

Natyrisht është përgatitur edhe drafti përkatës i vendimit, ku në dispozitiv është përcaktuar se: Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për transferim të përkohshëm deri në 1 vit; Thirrja për transferim t'i drejtohet të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë që plotësojnë kriteret për pozicionin e lirë të shpallur, të cilët ftohen për të dhënë pëlqimin për transferimin e

përkohshëm pranë gjykatës së sipërcituar; Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm është deri në datën 26.07.2019; Thirrja për transferim të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm; Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Përpara se të kalojmë aktin për miratim, në votim, kemi...

Po, zoti Bici, keni fjalën!

Medi Bici: Nuk kam ndonjë gjë me aktin, por dua të them se kishte një pasaktësi. Se në momentin që kemi miratuar komandimin e gjyqtarit {...} më datë 17.06.2019, gjyqtari {...} ka qenë i shkarkuar nga detyra nga KPK dhe nuk është shkarkuar mbrapa. Bile ka pasur propozim në seancë që gjyqtari {...} të rrijë në detyrë deri në 1 vit dhe Këshilli nuk e mori parasysh. Prandaj duhet të jemi më largpamës.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Ndoshta herë tjetër duhet të kemi parasysh rrethanat e situatave më mirë.

Brunilda Kadi: Është e vërtetë kjo që thotë zoti Bici, por ne e kemi diskutuar këtë dhe ne nuk mund ta paragjykojmë situatën, plus që zoti {...} vjen nga një gjykatë në të cilën neve kemi çuar një gjyqtar tjetër dhe këtë ne e kemi diskutuar. Situata s'është fare normale, që ne të vazhdomë të lejmë zotin {...} aty, kur ndërkohë, në vend të tij, kemi çuar dikë tjetër. Kjo është situatë më absurde, s'ka ku të shkojë.

Medi Bici: S'më kuptove zonja Brun! Nuk më kuptove!

U pasqyrua në relacion që zoti {...} është shkarkuar pasi ne kemi bërë komandimin. Këtë thashë.

Naureda Llagami: Atëherë, herë tjetër në fakt, duhet të jemi pak, ndoshta edhe më të kujdesshëm në situata.

Kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Brikena Ukperaj: Në fakt, nuk e shikoj që është pasaktësi në fakt në relacion sepse zoti {...} është transferuar para se të krijohet KLGJ-ja, është transferuar me vendim të KLD-së dhe ka një vijueshmëri vendimmarrjeje. Aktualisht për zotin {...} ne bëmë

përsëritje të transferimit, nuk është se vendosëm transferimin dhe pastaj, pozicionin që sot Komisioni i Karrierës shpall si pozicion të lirë të përkohshëm, nuk është pozicioni i zotit {...}, është një pozicion tjetër.

Marçela Shehu: Është kjo që thotë Brikena, pra pozicioni që Këshilli shpall sot, që Komisioni propozon për të shpallur sot, nuk ka lidhje me pozicionin e zotit {...}. Në momentin që Këshilli vendosi që zoti {...} të jetë i transferuar deri më datën 15 shtator, zonja {...} ushtronte akoma detyrën e gjyqtares. Pra ne nuk ishim në kushtet në të cilat jemi sot.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë për votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për transferim të përkohshëm deri në 1 vit; Thirrja për transferim t'i drejtohet të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë që plotësojnë kriteret për pozicionin e lirë të shpallur, të cilët ftohen për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm pranë gjykatës së sipërcituar; Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm është deri në datën 26.07.2019; Thirrja për transferim të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së

transferimit të përkohshëm; Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.07.2019)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
8. *Erton Karagjozi, EURALIUS.*
9. *Rezart Alija, EURALIUS.*
10. *Helios Reveli, EURALIUS.*
11. *Migena Kondo, KSHH.*
12. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
13. *Julinda Karaboja, USAID.*

RENDI I DITËS:

5. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Shqyrtimi i projekt-aktit të fundit, i cili ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Projekt-akti do të propozohet nga kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, përsëri edhe këtë muaj vijoje me procedurat për caktimin e gjyqtarëve në çështjet gjyqësore të veçanta, ndërsa gjykatat, vazhdimisht janë në të njëjtën rend nevojë si edhe muajt e tjerë të mëparshëm. Ndërsa janë disa gjykata në nevojë. Kemi propozuar edhe për ndjekjen e një shkalle të procedurave të shortit, të cilën do duhet ta miratojmë fillimisht. Është propozuar që radha e shortit të fillojë me gjykatat e apeleve, sipas këtij rendi: fillimisht gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Durrës, Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Më pas vijoje me Gjykatën Administrative të Apelit. Në fund, me Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

Më pas procedurat e shortit propozohet që të vijoje me gjykatat e shkallës së parë sipas kësaj radhe: fillimisht gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksionit të gjykatës së apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht gjykata e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, më pas Krujë, Tiranë dhe në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat. Më pas shortet të zhvillohen për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, fillimisht për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe më pas për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Më pas procedurat e shortit do të vijoje me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ku është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Më tej procedurat e shortit të vijoje me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë, fillimisht Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe më pas Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Më tej procedurat e shortit të vijoje me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë, ku është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Në fund, procedurat e shortit do të ndiqen për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, sipas kësaj radhe: fillimisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe më pas Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit zoti Toska!

Biem dakord për radhën e propozuar nga Komisioni?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Atëherë, zoti Toska të fillojë procedurën, bashkë me stafin administrativ. Sikurse edhe për të testuar programin e ri.

(Anëtarët e Këshillit bëjnë një pauzë të shkurtër, për të rifilluar mbledhjen si më poshtë.)

Atëherë, zoti Toska, vazhdojmë me hedhjen e shortit sipas radhës së miratuar.

Ilir Toska: Mirë atëherë, fillojmë procedurat e shortit sipas radhës së miratuar.

Gjykata e Parë është **Gjykata e Apelit Korçë**.

Gjykata e Apelit Korçë ka paraqitur nevojë për 14 çështje gjyqësore, nga të cilët 9 janë civile dhe 5 penale. Në këtë rast nuk mund të zbatohet mekanizmi i skemës së delegimit për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve në këtë skemë, ndërkohë që nuk është i dobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, ndërsa do duhet për çështjet në nevojë, të paktën 3 gjyqtarë, ndërkohë që transferimi i përkohshëm i tre të tillëve do të ishte e padobishme për shkak se të tre gjyqtarët do duhet të dorëzojnë një numër të konsiderueshëm çështjesh në gjykatën në të cilën ato duhet të transferohen. Për këtë arsye, bëhet i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Nisur nga kjo, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 14 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Renda. Ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 14 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 9 gjyqtarë, 5 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë, 2 nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe 2 nga Gjykata e Apelit për Krimet e Renda. Jeni dakord me këtë?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Dakord. Mirë atëherë, meqenëse Këshilli është dakord me propozimin e parë, vijojmë me propozimin e dytë: ndërsa gjyqtarët do të caktohen nga 3 gjykata apeli, duke patur në konsideratë numrin e gjyqtarëve që kërkohen të caktohen për secilën çështje, si dhe mënyrën e formimit të trupave gjykues për çështjet në nevojë sa i përket gjyqtarëve të caktuar më herët nga gjykatat e tjera të apelit, për hapat e shortit që duhet të ndiqen,

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që: Për 2 çështjet civile, ato nr. 8 dhe nr. 9, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë; Ndërsa për 3 çështjet civile, ato nr. 1, nr. 6 dhe nr. 7, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet 2 gjyqtarëve të Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë të caktuar për çështjet civile nr. 8 dhe nr. 9. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur e para përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër. Për çështjen e mbetur hidhet përsëri short midis dy gjyqtarëve; Më tej për çështjen civile nr. 2, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër; Ndërsa për çështjen civile nr. 4, për të cilën kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari, për ekonomizim të burimeve njerëzore referuar për këtë në pikën 4 të Kreut VII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në këtë rast vlen të konsiderohet shorti i datës 20.05.2019, duke u konsideruar si i përzgjedhur nga short gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, që është në përbërje të trupit gjykues bashkë me gjyqtaren {...}, konkretisht gjyqtari {...}; Për çështjet civile nr. 3 dhe nr. 5, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për ekonomizim të burimeve njerëzore të konsiderohen shortet e hedhura më parë për këto çështje, përmes të cilave, në secilën nga këto çështje, është caktuar nga 1 gjyqtar i Gjykatës së Apelit për Krimet e Renda, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...}, ku të dy ata të plotësojnë trupat gjykues në dy çështjet në nevojë. Konkretisht, për çështjen nr. 3, si e përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtarja {...}. Ndërsa për çështjen nr. 5, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari {...}; Për 5 çështjet penale, ato nr. 10, nr. 11, nr. 12, nr. 13 dhe nr. 14, për të cilat kërkohet caktimi i 1, 2 dhe 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe konkretisht: Për çështjen nr. 12, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari është automatikisht dhe relator i çështjes. Për çështjet nr. 10, nr. 11 dhe nr. 13, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen 2 gjyqtarët që nuk janë caktuar si relator për

çështjen nr.12. Për çështjen nr. 14, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari i caktuar relator për çështjen nr. 12.

Referuar këtij propozimi, vijon edhe propozimi për sa i përket përjashtimeve nga shorti. Ku në lidhje me çështjen civile nr. 2 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje dhe konkretisht: {...} dhe {...}; Në shortimin e çështjeve penale të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë që është anëtar i Kolegjit Zgjedhor, në kushtet kur ky Kolegji është thirrur në detyrë dhe është aktualisht i mbledhur, konkretisht: gjyqtari z. {...}; Në shortimin e çështjeve penale të përjashtohen nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, që është në prag të mbushjes së moshës së pensionit, që është z. {...}; Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e më tepër se 10 çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht gjyqtarët: {...} dhe {...}.

Jeni dakord me këto propozime që kemi bërë?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Mirë atëherë, vijojmë procedurat e shortit sipas propozimeve të miratuara.

Për çështjet civile nr. 8 dhe nr. 9, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë. Do zhvillojmë procedurat e shortit. Në një enë do të fusim emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë të Seksionit Civil, që janë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Këto janë emrat e gjyqtarëve. Në enën tjetër janë dy çështjet civile 8 dhe 9. Për të dy ato do të përzgjedhim dy gjyqtarë.

Do të përzgjedhim emrat e dy gjyqtarëve.

Atëherë, emri i parë i përzgjedhur është {...}. Emri i dytë është {...}. Të cilët caktohen për çështjet civile nr. 8 dhe 9.

Për tre çështjet civile 1, 6, 7 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, u pranua propozimi që ai të përzgjidhet me short ndërmjet dy gjyqtarëve të Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë të caktuar për çështjet nr. 8 dhe nr. 9 (midis gjyqtarëve {...})

dhe {...}). Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur e para, përjashtohet nga shorti për çështjen e renditur më pas dhe bëhet short për çështjen e tretë.

Në një enë të do të fusim çështjet nr. 1, 6 dhe 7 dhe në enën tjetër, emrat e dy gjyqtarëve.

Përzgjidhet çështja – Çështja nr. 1 – gjyqtari i përzgjedhur është {...}.

Përzgjidh një çështje tjetër – Çështja nr. 7 – emri i gjyqtares, {...}.

Do të bëjmë shortin midis dy gjyqtarëve për çështjen nr. 6. Do zgjedhim emrin e një gjyqtari – {...}.

Vazhdojmë për çështjen civile nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të apelit Shkodër, për të përzgjedhur njërin prej tyre. Në këtë rast përjashtohet nga shorti gjyqtarët {...} dhe {...}, që janë caktuar për këtë çështje më herët.

Emri i parë është {...}, {...}, {...}, {...}, {...} (është anëtar i Kolegjit Zgjedhor dhe përjashtohet nga shorti) dhe {...}. Përzgjidh emrin e një gjyqtari. Është {...}.

Për çështjen civile nr. 4, për të cilën është kërkuar caktimi i një gjyqtari, u pranua propozimi që të caktohet gjyqtari që është në të njëjtin trup gjykues me gjyqtaren {...}, që është përzgjedhur me herët me short për caktimin e çështjes nr. 4, që është gjyqtari {...}. S'ka nevojë për të zhvilluar një procedurë specifike shorti.

Për çështjet civile nr. 3 dhe nr. 5 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast u pranua propozimi që për çështjen nr. 3, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtarja {...}, ndërsa për çështjen nr. 5, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari {...}.

Për 5 çështjet civile nr. 10, 11, 12, 13 dhe 14, sipas propozimit të pranuar, do të zhvillojmë shortin për çështje nr. 12 për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve që duhet të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari është automatikisht dhe relatori i çështjes. Fusim në një enë gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke përjashtuar gjyqtarët {...} (anëtar i Kolegjit Zgjedhor), {...} (në prag të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë) dhe gjyqtarët {...} dhe {...} që janë caktuar më herët në më tepër se 10 çështje

gjqësore. {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Atëherë do përmendim emrat e tre gjyqtarëve të përmendur më lart – Emri i parë është {...} që caktohet edhe relatore për çështjen nr. 12. Emri i dytë është {...}. Emri i tretë është {...}. Këto janë gjyqtarët për çështjen 12.

Ndërsa për çështjen 10, 11, 13, sipas propozimit të pranuar caktohen në përbërje të trupit gjykues dy gjyqtarët që nuk u caktuan relator për çështjen nr. 12, që janë {...} dhe {...}.

Ndërkohë që për çështjen nr. 14, sipas propozimit që u pranua edhe nga Këshilli, caktohet në përbërje të trupit gjykues gjyqtari relator për çështjen 12 që është gjyqtarja {...}. Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vijojmë me **Gjykatën e Apelit Durrës**. Gjykata e Apelit Durrës ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, që janë të treja në lëndë penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit për shkak të padisponueshmërisë në skemë të gjyqtarëve, ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Referuar këtij të fundit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ka propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit për Krimet e Renda dhe Gjykata e Apelit Shkodër. Ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, në kushtet e pranimin të këtij propozimi, vijojmë me propozimin e dytë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, që konsiston në duke patur në konsideratë formimin më herët të trupave gjykues për çështjet në nevojë për caktim gjyqtari, si dhe për ekonomizim të burimeve njerëzore referuar pikës 4 të Kreut VII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, propozohet që për çështjen nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 1

gjqytari, ai të përzgjidhet, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Për çështjet nr.2 dhe nr.3, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato gjyqtari të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, të cilët janë në përbërje të trupit gjykues bashkë me gjyqtaren {...}, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet për çështjen nr.2, ndërsa gjyqtari tjetër caktohet për çështjen nr.3.

Në këtë rast do duhet të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, zonja {...}, po kështu duhet të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda që janë caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Korçë, që janë zoti {...} dhe znj. {...}. Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, vijojmë me procedurat e shortit.

Për çështjen nr. 1 që kërkon caktimin e 1 gjyqtari ai të përzgjidhet, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të apelit për krimet e rënda, duke përjashtuar emrat e zonjës {...}, zotit {...} dhe zonja {...}.

Atëherë, emri i parë është {...}, emri i dytë është {...}, emri i tretë është {...}, emri i katërt është {...} dhe i fundit {...}. Do të përzgjedhim njërin prej tyre që do të caktohet për çështjen nr. 1.

Është {...}.

Vazhdojmë procedurat për çështjen nr. 2 dhe nr. 3 që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. U pranua propozimi që të zgjedh mes dy gjyqtarëve që janë në përbërje të trupit gjykues bashkë me gjyqtaren {...}, e cila është caktuar më herët në këtë çështje gjyqësore. Dy gjyqtarët që janë në përbërje të trupit gjykues me gjyqtaren {...} të Gjykatës së Apelit Shkodër janë: {...} dhe {...}. Do të fusim në një enë emrat e dy gjyqtarëve, ku gjyqtarja e përzgjedhur e para do të caktohet për çështjen nr. 2, ndërsa ai që mbetet, për çështjen nr. 3.

Emri i parë që përzgjidhet është {...}, që caktohet për çështjen nr. 2.

Dhe për çështjen nr. 3 është gjyqtari tjetër, {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Durrës.

Vijojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Vlorë**, e cila ka paraqitur nevojë në 6 çështje gjyqësore (2 civile dhe 4 penale). Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit për shkak të padisponueshmërisë të gjyqtarëve në këtë skemë, ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm në këtë rast zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme., ku në kuadër të të cilit kemi propozuar Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit për Krimet e Renda dhe Gjykata e Apelit Korçë dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 5, 1 gjyqtar nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, 1 gjyqtar nga Gjykata e Apelit Korçë dhe 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Meqenëse Këshilli është dakord me propozimin si më lart, vijojmë me propozimet e mëtejshme.

Ndërsa gjyqtarët do të caktohen nga tre gjykata të ndryshme, duke patur në konsideratë numrin e gjyqtarëve që kërkohen të caktohen për secilën çështje, formimi më herët i trupave gjykues për çështje në nevojë për caktim gjyqtari si dhe për ekonomizim të burimeve njerëzore referuar pikës 4 të Kreut VII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni ka këto propozime: Për çështjen nr. 1 dhe nr. 3 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Për çështjen nr. 4 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë. Për çështjen nr. 5, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari është automatikisht edhe relatori i çështjes. Për çështjen nr. 2 dhe nr. 6,

për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen 2 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, të caktuar si anëtarë për çështjen nr. 5, ku gjyqtari i përzgjedhur i dyti caktohet për çështjen nr. 2, ndërsa ai i përzgjedhur i treti, për çështjen nr. 5 (*lapsus numri i çështjes, bëhet fjalë për çështjen nr. 6*).

Në këtë rast kemi propozuar të përjashtohet nga shorti për çështjen nr. 1 dhe nr. 3, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda që janë caktuar më herët për gjykimin e tyre, që janë gjyqtarët {...} dhe {...}. Për çështjen nr. 4 përjashtohen nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Korçë, zonja Brunilda Orhani. Dhe për çështjen nr. 2, nr. 5 dhe nr. 6, përjashtohen nga shorti kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, zoti {...}.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Atëherë vijojmë me procedurat e shortit.

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 3 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, që do të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, duke përjashtuar emrat e gjyqtarëve {...} dhe {...}, krahas edhe emrit të kryetares në detyrë të kësaj gjykate dhe janë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Do të përzgjedhim njërin prej tyre që do të caktohet për të dy çështjet nr. 1 dhe nr. 3 – Është {...}.

Vazhdojmë për çështjen nr. 4 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, do të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë. Në këtë rast do të përjashtohet nga shorti vetëm kryetarja në detyrë, zonja Brunilda Orhani. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, që janë: {...}, {...}, {...}. Atëherë, zoti {...} është në përbërje të trupit gjykues, kështu që nuk duhet të marri pjesë në short për këtë çështje. Do të zgjedhim një prej gjyqtarëve të tjerë – Që është {...}.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për çështjen nr. 5, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, që do të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Në këtë rast, gjyqtari që do të përzgjidhet i pari është edhe relator për çështjen nr. 5. Ndërkohë që gjyqtari që do të përzgjidhet i dyti është anëtar për çështjen nr. 2, ndërsa ai që do të përzgjidhet i treti është anëtar tek çështja nr. 6.

Atëherë, emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë që do të hidhen në enë janë: {...}, {...}, {...}, {...}.

Atëherë do të përzgjedhim emrat e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. I pari është {...}, i cili caktohet edhe relator për çështjen nr. 5. Emri i dytë është {...}, e cila caktohet si anëtare për çështjen nr. 5 dhe anëtare për çështjen nr. 2. Emri i tretë është {...} që caktohet anëtar për çështjen nr. 5 dhe për çështjen nr. 6. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Gjirokastrë**.

Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka paraqitur nevojë për 8 çështje gjyqësore, nga të cilat 6 janë civile dhe 2 janë penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve në këtë skemë. Është i padobishëm zbatimi i transferimit të përkohshëm në këtë gjykatë për shkak se nuk ka pozicion të lirë të përkohshëm apo të përhershëm, ndërkohë që do duhet të zbatojmë mekanizmin e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cili, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar se gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 8 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 8 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 6. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Ndërsa pranohet ky propozim, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, kemi bërë këto propozime: Për 3 çështjet civile, ato nr.1, nr.2 dhe nr.5, për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short, midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë përcakton dhe përzgjedhjen e dy gjyqtarëve të tjerë, që janë në përbërje të trupit gjykues në gjykatën nga e cila vijnë, me gjyqtarin e përzgjedhur i pari. Ky i fundit është automatikisht relator për çështjen e renditur e para në listë, ndërsa shorti vijon për përcaktimin e relatorit në dy çështjet e renditura më pas, ku ai i përzgjedhur fillimisht caktohet relator për çështjen nr.2, ndërsa gjyqtari tjetër caktohet si relator për çështjen nr.5.

Për çështjen civile nr.3, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të caktuar për çështjet nr.1, nr.2 dhe nr.5.

Ndërsa, për çështjen civile nr.4, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari që nuk është përzgjedhur për çështjen nr.3.

Për 2 çështjet penale, ato nr.7 dhe nr.8, për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen gjyqtarët e trupit tjetër gjykues të Gjykatës së Apelit Vlorë. Në këtë rast, shorti zhvillohet për caktimin e gjyqtarit relator për secilën çështje, ku ai i përzgjedhur i pari caktohet relator për çështjen e renditur e para në liste, ndërsa gjyqtari i përzgjedhur i dyti caktohet relator për çështjen e renditur më mbas në listë.

Për çështjen civile nr.6, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari që nuk është caktuar relator për çështjet penale nr. 7 dhe nr. 8.

Në këtë rast kemi propozuar për përjashtimet nga shorti, të përjashtohet kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, zonja {...} dhe gjyqtarja e kësaj gjykate që është njëherazi edhe anëtare e Kolegjit Zgjedhor, zonja {...}. Është e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. E ngatërrova.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, meqenëse u pranuan propozimet e Komisionit, vijojmë me procedurat e shortit.

Për tre çështjet civile 1, 2, 5, siç kundër u pranua propozimi, do caktohen tre gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari përcakton automatikisht edhe përbërjen e trupit gjykues. Do të hedhim në enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër që janë {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Do të përzgjedhim njërin prej tyre duke u përcaktuar automatikisht edhe përbërja e trupit gjykues – Është emri i {...}t. Referuar informacionit të marrë nga Gjykata e Apelit Vlorë, në përbërje të trupit gjykues me {...}n janë edhe gjyqtarët {...} dhe {...}.

Do të zhvillojmë procedurë shorti për caktimin e relatorit mes tre gjyqtarëve si më lart për çështjen nr.1, nr.2 dhe nr.5. Do të hedhim në një enë çështjet nr. 1, 2 dhe 5 dhe në enën tjetër emrat e tre gjyqtarëve si më lart.

Atëherë, përzgjedhim çështjen e parë – është çështja nr. 1. Do të përzgjedhim emrin e gjyqtarit që është edhe relator - {...}.

Çështja e përzgjedhur e dyta është me numër 3 (*lapsus nr. i çështjes, pasi është çështja nr. 5*). Përzgjedhim emrin e një gjyqtari – {...}.

Dhe çështja e fundit është çështja nr. 2, që mbetet të jetë relator gjyqtarja {...}.

Për çështjen civile nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short, ndërmjet gjyqtarëve të caktuar për çështjen 1, 2 dhe 5. Pra duhet të hedhim në një enë emrat e tre gjyqtarëve: {...}, {...} dhe {...}, për të përzgjedhur emrat e dy prej tyre. Emri i parë i përzgjedhur është {...}. Emri i dytë është {...}. Të dy caktohen për çështjen civile nr. 3.

Për çështjen civile nr. 4, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari që nuk është përzgjedhur për çështjen nr.3 – që mbetet të jetë gjyqtari {...}.

Vazhdojmë me 2 çështjet penale, ato nr.7 dhe nr.8, për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Është pranuar propozimi që të caktohet tre gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Apelit Vlorë që nuk u caktuan për çështjet e përmendura më lart, që janë {...}, {...} dhe {...}. Në këtë rast do të zhvillojmë procedurën për caktimin e relatorit për këto dy çështje. Në një enë do të hedhim emrat e gjyqtarëve dhe në enën tjetër dy çështjet.

{...}, {...} dhe {...} në një enë. Numrat 7 dhe 8 të çështjeve. Do të përzgjedhim një të njëjtën çështje.

Çështja e përzgjedhur e para është nr.8.

Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari.

Është {...}, caktohet relator për çështjen nr. 8.

Për çështjen nr. 7 do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari për relator.

Që është {...}.

Për çështjen civile nr. 6 është pranuar propozimi që të konsiderohet i përzgjedhur emri i gjyqtarit të tretë që nuk do caktohet për çështjen nr. 7 dhe nr. 8 si relator, që është emri i gjyqtarit {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Vijojmë me **Gjykatën Administrative të Apelit**. Gjykata Administrative e Apelit, për herë të parë paraqet nevojë për 2 çështje. Në të dy rastet kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve në këtë skemë. Ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të skemës së transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këtë propozim: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Në kushtet kur u pranua ky propozim, propozimet vijuese janë që për secilën nga dy çështjet për të cilat kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të seksionit civil të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast, gjyqtarët e përzgjedhur për çështjen e renditur e para në listë, përjashtohen nga shorti për çështjen pasrendëse.

Po kështu, propozimet që janë në lidhje me përjashtimet nga shorti që konsistojnë në përjashtimin nga shorti të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë, zotit {...}, përjashtimin nga shorti të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë {...} dhe {...}. Po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Apelit Tiranë që do caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, që më herët ishin gjyqtarët {...} dhe {...}. Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Mirë atëherë, vijojmë me procedurat e shortit. Do të hedhim në një enë 2 numrat e 2 çështjeve, 1-shin, 2-shin dhe në enën tjetër emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë të seksionit civil (përjashtuar emrat e gjyqtarëve {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}). Emrat e tjerë janë {...}, {...}, {...} është anëtar i KED-së, përjashtohet nga shorti, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Atëherë, përzieji dhe përzgjidh një të çështje. Çështja e përzgjedhur e para është çështja nr. 2. Do të përzgjedhim emrat e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë të seksionit civil. Emri i parë është {...} dhe emri i dytë është {...}.

Vazhdojmë për çështjen nr. 1. Do të përzgjedhim emrat e dy gjyqtarëve. Emri i parë është {...}. Emri i dytë është {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën Administrative të Apelit.

Vazhdojmë procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda**. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore të veçantë. Në këtë rast është i pazbatueshëm zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit, sikundër është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka bërë këtë propozim: Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtari që do caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve do caktohen për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë 1. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Faleminderit!

Në vijim të këtij propozimi, duke patur në konsideratë formimin më herët të trupit gjykues për këtë çështje në nevojë për caktimin e një gjyqtari, për ekonomizim të burimeve njerëzore, referuar për këtë pikës 4 të Kreut VII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, vlen të konsiderohet shorti i datës 17 qershor për mes të cilit, për këtë çështje, nga KLGJ është caktuar përmes shortit një gjyqtar i seksionit penal i gjykatës së

Apelit Tiranë, konkretisht zoti {...}. Në rast të pranimit të këtij propozimi, për hapat e shortit që duhet të ndiqen është që, për një çështje, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët janë në përbërje të trupit gjykues bashkë me gjyqtarin {...}. Ndërkohë të përjashtohet nga shorti gjyqtari që është i Gjykatës së Apelit Tiranë, seksioni penal, që është anëtar i Kolegjit Zgjedhor, zoti {...}.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Atëherë, vijomë me procedurat e shortit. Në përbërje të trupit gjykues bashkë me gjyqtarin {...} që është caktuar më herët në këtë çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda janë gjyqtarët {...} dhe {...}. Ndërkohë që gjyqtari {...} përjashtohet nga shorti për shkak të qenies anëtar në Kolegjin Zgjedhor dhe Kolegji Zgjedhor është i mbledhur, mbetet vetëm gjyqtari {...}, kështu që nuk ka nevojë që të zhvillojmë një procedurë shorti, pasi gjyqtari {...} caktohet për çështjen në nevojë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Vijomë me procedurat e shortit për gjykatat e shkallës së parë në juridiksionin e përgjithshëm. Fillimisht për gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka paraqitur nevojë për 7 çështje, nga të cilat 6 penale dhe 1 civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit sikundër është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë kështu i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve të jetë 3. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Atëherë, vijojmë me propozimet në lidhje me hapat e mëtejshme të shortit. Kemi propozuar këtu për 6 çështjet penale, në të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilin grup çështjesh, grupin e parë që përfshin çështjet penale nr.1, nr.2 dhe nr.3, si dhe grupin e dytë që përfshin çështjet nr.4, nr.5 dhe nr.6, gjyqtari të përzgjidhet, me short, midis gjyqtarëve të Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për grupin e çështjeve të renditura të parat në listë, përjashtohet nga përzgjedhja për grupin e çështjeve të renditura më mbas në listë.

Ndërsa për 1 çështje civile, atë nr.7, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet, me short, midis gjyqtarëve të Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këtë rast kemi propozuar për t'u përjashtuar nga shorti gjyqtarët që janë me leje lindjeje apo me leje afatgjatë, zonja {...} dhe {...}. Po kështu të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}. Të përjashtohet nga shorti gjyqtari {...} i cili Këshilli më herët ka vendosur përjashtimin nga shorti të tij për 6 muaj nga caktimi i çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme. Po kështu kemi propozuar të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e seksionit penal të çështjeve penale të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e tre apo më tepër çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Kemi propozuar të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Jeni dakord me këto propozime?
(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Atëherë, vijojmë me procedurat e shortit. Atëherë, për 6 çështjet penale për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari kemi propozuar që të ndahen në dy grupe, njëri grup të ketë çështjet 1, 2, 3 dhe grupi i dytë të ketë çështjet 4, 5, 6 dhe për secilin grup u pranua propozimi të përzgjidhet 1 gjyqtar nga seksioni penal i çështjeve penale të

themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Do të hedhim në një enë dy grupet e çështjeve dhe në enën tjetër emrat e gjyqtarëve, duke përjashtuar ata që u pranua më lart propozimi. Emrat e gjyqtarëve që duhet të hidhen në enë janë: {...} dhe {...}. Të tjerët përjashtohen. Atëherë, do zgjedhim grupin e parë – Grupi i parë është 4, 5, 6. Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari. Është {...}. Ndërsa për çështjet 1, 2, 3 mbetet të jetë gjyqtari {...}.

Do të vazhdojmë procedurat e shortit për çështjen civile nr. 7, që do të përzgjidhet 1 gjyqtar nga seksioni civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke përjashtuar ata që më herët Këshilli pranoi përjashtim nga shorti për shkak se kanë gjykuar më herët çështje në gjykata të tjera. Emrat që do të hyjnë në enë janë {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Është shkarkuar sot?

Atëherë e përjashtojmë, për shkak të vendimit të KPK gjyqtarja {...} është shkarkuar, për këtë shkak është e pezulluar nga detyra.

{...} është emri i fundit. Do të përzgjedhim njërin prej këtyre emrave që do të caktohet për çështjen civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin – Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka paraqitur nevojë për 3 çështje (2 civile dhe 1 penale). Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e tre çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre 3 çështjeve, të jetë 1. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Meqenëse u pranua ky propozim, në lidhje me hapat e shortit, Komisioni ka këto propozime: për 3 çështjet, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar faktit se dy nga çështjet në nevojë janë në lëndë civile, ndërsa çështja e tretë që është lëndë penale është për përjashtim gjyqtari.

Po ashtu kemi propozuar të përjashtohen nga shorti gjyqtari {...} që është përjashtuar nga shorti me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për një periudhë 6-mujore. Përjashtohen nga shorti gjyqtarët që janë caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, pra

{...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Po kështu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtari që do të caktohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, që më herët ishte gjyqtarja {...}. Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, vijojmë procedurën e shortit për të përzgjedhur emrin e 1 gjyqtari të seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që do caktohet në tre çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Emrat janë {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Këto janë emrat. Do të përzgjedhim njërin prej tyre – Emri i përzgjedhur është {...} e cila caktohet për 3 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, që ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të

veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë të jetë 1. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Ndërsa u pranua ky propozim, propozimet vijuese për hapat e shortit që duhet të ndiqen janë: Për 1 çështje, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ku këtu të përjashtohet vetëm kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, zonja {...}. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë që janë {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërës prej tyre që do të caktohet për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Emri i përzgjedhur është {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka paraqitur nevojë për 2 çështje në lëndë penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtari që do caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e këtyre 2 çështjeve të jetë 1. Jeni dakord me këtë?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Meqenëse u pranua ky propozim, në vijim për hapat e shortit, Komisioni propozon që për 2 çështjet të caktohet 1 gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë që do të zgjidhet me short, ndërsa duhet të përjashtohet nga shorti gjyqtari që do caktohet për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ishte gjyqtarja {...}. Kemi propozuar që në këtë rast të mos përjashtohet nga shorti kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, zonja {...}, për shkak të numrit të

kufizuar të gjyqtarëve në këtë gjykatë dhe numrit jo të lartë të çështjeve që do duhet të gjykojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, fusim në një enë emrat e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë që janë {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërës prej tyre që do të caktohet për të dy çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat – {...}. Mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka paraqitur nevojë për 1 çështje në lëndë civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje të jetë 1. Jeni dakord me këtë?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Në vijim të këtij propozimi për hapat e shortit, përveç faktit që duhet të përzgjidhen me short mes gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë, zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, zoti {...}, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe numrit të ulët të çështjeve që ai duhet të gjykojë. Jeni dakord me këtë?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, që janë {...} dhe {...}.

Do të përzgjedhim njërin prej tyre që do të caktohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Emri i përzgjedhur është {...}. Mbyllim procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë**, që ka paraqitur nevojë për 9 çështje, nga të cilat penale janë 4 dhe 5 janë civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 5. Jeni dakord me këtë?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë! Ndërsa u pranua ky propozim, lidhur me hapat e shortit, kemi këto propozime për Këshillin e Lartë Gjyqësor: Për çështjen penale nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen tre gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të cilët kanë gjykuar themelin e çështjes, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, ndërsa kërkohet ndreqja e gabimit material në vendimin e dhënë nga ata.

Për çështjen penale nr. 4 për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti konsiderohen 3 gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, njëri nga të cilët i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, të cilët kanë gjykuar themelin e çështjes, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, ndërsa kërkohet ndreqja e gabimit material në vendimin e dhënë nga ata.

Për çështjet penale nr. 1 dhe nr. 2 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të caktuar për çështjen nr. 3.

Ndërsa për 5 çështjet civile për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në këtë rast gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur e para, përjashtohet nga shorti për çështjen e përzgjedhur më pas e kështu me radhë.

Kemi bërë propozim që mos të përjashtohen nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, zonja {...}, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe numrit të ulët të çështjeve që ata duhet të gjykojnë pranë saj. Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Vazhdojmë me procedurat e shortit.

Atëherë, u pranua propozimi që për çështjen nr. 3 që ka të bëjë me ndreqje gabimi material, të gjykojnë tre gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen e themelit, që janë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 4 po ashtu u pranua propozimi që të caktohen tre gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen penale të themelit që janë {...}, {...} dhe {...}.

Ndërkohë, do duhet të zhvillojmë procedurën e shortit për çështjet penale nr. 1 dhe nr. 2 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari që do të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të caktuar për çështjen nr. 3, pra mes gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Fusim në një enë çështjet nr. 1 dhe nr. 2 dhe në enën tjetër emrat e tre gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjidhet çështja e parë – çështja nr. 1. Emri i gjyqtari që përzgjidhet për këtë çështje është – {...}. Për çështjen nr. 2 – emri i gjyqtarit të përzgjedhur është – {...}.

Vazhdojmë procedurat e shortit për 5 çështjet civile për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari që do të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e rrethit gjyqësor Pukë. Do të fusim në një enë 5 çështjet civile, që janë çështjet 5, 6, 7, 8, 9. Dhe emrat e 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, që janë emrat e gjyqtarëve {...} dhe {...}.

Përzgjedhim çështjen e parë. Është çështja nr. 7. Përzgjedhim emrin e një gjyqtari – {...}.

Përzgjedhim çështjen tjetër. Çështja nr. 8. Që është emri i gjyqtarit – {...}.

Vazhdojmë procedurat duke futur emrat e dy gjyqtarëve në enë dhe përzgjedhim çështjen e radhës. Çështja që përzgjidhet është me nr. 6. Emri i gjyqtarit për këtë çështje është {...}.

Përzgjedhim një çështje tjetër. Çështja është nr. 5. Për të cilën caktohet gjyqtari – {...}.

Ka mbetur edhe një çështje. Do të hedhim përsëri në enë emrat e dy gjyqtarëve për të përzgjedhur emrin e njërit prej tyre. Çështja që ka mbetur është me nr. 9. Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari - {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit dhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Vijojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka paraqitur nevojë për 2 çështje, që janë të dyja në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre 2 çështjeve të jetë 1. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Ndërsa ky propozim u pranua, lidhur me hapat e shortit, Komisioni ka këto dy propozime: propozimi i parë është ai që u pranua edhe më lart që të zgjidhen me short nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë emri i një gjyqtari për të dy çështjet dhe të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, zoti Sokol Pine. Po kështu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që është caktuar më herët në 5 apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrorjnë funksionin në mënyrë të përhershme, zonja {...}. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që janë {...}, {...}. Këto dy emrat janë që do marrin pjesë në short. Të tjerët u përjashtuan. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre – është {...} që caktohet për të dy çështjet në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë**, e cila ka paraqitur nevojë për 2 çështje, të dyja në lëndë penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e tyre, të jetë 2. Është bërë ky propozim për shkak se është e njëjta palë dhe për të mos patur konfondime për të dy çështjet. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, ndërsa pranohet ky propozim, propozimi është që ndërsa çështjet janë në lëndë penale, dy gjyqtarët të përzgjidhen nga seksioni penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku të përjashtohet kryetarja në detyrë e kësaj gjykate, zonja {...}. Po kështu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, që janë zoti {...}, zoti {...} dhe zonja {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Atëherë, zhvillojmë procedurat e shortit. Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që janë {...}, {...}. Në një enë tjetër duhet të fusim dy çështjet që janë 1-shi dhe 2-shi. Përzgjedhim një të çështje. Çështja e parë është 2-shi. Përzgjedhim emrin e gjyqtarit për këtë çështje – {...}.

Çështja që mbetet është çështja nr. 1 dhe emri i gjyqtarit që mbetet është {...}.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vijojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka paraqitur nevojë për 1 çështje penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, po kështu është padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të

gjqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për këtë të jetë 3, aq sa kërkohet nga gjykata në nevojë. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, ndërsa pranohet ky propozim, lidhur me hapat e shortit Komisioni propozon që për 1 çështje penale që kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari është automatikisht dhe relator i çështjes. Kemi propozuar që të përjashtohet nga shorti kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, zonja {...}. Jeni dakord?

Jeni kundër që të përjashtohet nga shorti zonja {...}? –Okej. Për shkak se njëra nga gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor...

(Zonja Ukperaj flet pa ndezur mikrofonin, që gjyqtarja znj. {...} merr lejen e lindjes dhe ajo duhet të përjashtohet nga shorti.)

Mendoni që duhet të përjashtohet gjyqtarja {...}.

Jeni dakord me propozimin që bën zonja Ukperaj?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Atëherë, duke përjashtuar gjyqtaren {...}, do të fusim në short të gjithë gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, që janë {...}, {...} dhe {...}. Meqenëse janë vetëm 3 gjyqtarë, do duhet të përzgjedhim vetëm njërin prej tyre për efekt të caktimit si relator. Vijojmë me përzgjedhjen. Emri i përzgjedhur i gjyqtarës është – {...}. Me kaq mbyllet edhe procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka paraqitur nevojë për një çështje civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, po kështu është padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen, të jetë 1. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Në vijim të propozimeve për hapat e shortit, Komisioni i propozon Këshillit që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë zonja Luljeta Kole e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme. Konkretisht zoti {...}, {...}, zoti {...}, zonja {...} dhe zonja {...}. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, fusim në një enë emrat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, përjashtuar ata që më herët u thanë. Janë zonja {...}, {...}, {...}, {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre. Emri i përzgjedhur është {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Vazhdojmë me **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë**. Ka paraqitur nevojë për 5 çështje. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm i gjyqtarit, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Ndërsa u pranua ky propozim, për hapat e mëtejshëm të shortit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që për çështjen nr. 3, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë i cili ka gjykuar çështjen, konkretisht gjyqtarja {...}, ndërsa kërkohet sqarimi dhe interpretim i vendimit të ndërmjetëm dhënë prej saj.

Për katër çështjet e tjera për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilin grup çështjesh, grupin e parë që përfshin çështjet 1 dhe 2 dhe grupin e dytë që përfshin çështjet 4 dhe 5, gjyqtari të përzgjidhet me short midis gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për grupin e çështjeve të renditura të parat në listë, përjashtohet nga përzgjedhja për grupin e çështjeve të renditura më mbas në listë.

Kemi propozuar të përjashtohen nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, zoti {...}, po kështu, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e katër apo më tepër çështje gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë zonja {...}, zoti {...}, zoti {...}, zonja {...}, zoti {...} dhe zonja {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Vazhdojmë me procedurat e shortit. Atëherë për çështjen nr. 3, u pranua propozimi që të caktohet gjyqtarja {...}, që ka gjykuar çështjen në themel, ndërsa kërkohet sqarimi dhe interpretimi i ndërmjetëm dhënë prej saj.

Vazhdojmë procedurat e shortit për 4 çështjet e tjera.

Do i ndajmë çështjet në dy grupe, 1-shi, 2-shi bashkë dhe 3-shi, 4-a bashkë (*lapsus nr. i çështjes, pasi bëhet fjalë për çështjen nr. 4 dhe 5*). Ndërkohë në enën tjetër do të hedhim emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që janë {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}. Atëherë përzgjedhim njërin grup çështjesh - Janë çështjet 4 dhe 5. Përzgjedhim emrin e një gjyqtari – {...}.

Grupi i dytë është 1-shi, 2-shi. Përzgjedhim emrin e një gjyqtari – {...}. Me kaq mbyllem procedurat e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Gjykata e fundit është **Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Korçë**. Ka paraqitur nevojë në 5 çështje. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i propozon Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Ndërsa pranohet ky propozim, për hapat e shortit kemi këto propozime.

Për 5 çështjet në të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilin grup çështjesh, grupin e parë që përfshin çështjet nr. 1 dhe nr. 2 si dhe grupin e dytë që përfshin çështjet nr. 3, 4 dhe 5, gjyqtari të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në këtë rast gjyqtari i përzgjedhur për grupin e çështjeve të përzgjedhura të para, të përjashtohet nga përzgjedhja për grupin e çështjeve të tjera. Kemi propozuar që të mos përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve në këtë gjykatë, por edhe numrit jo të lartë të çështjeve që ajo duhet të gjykojë, zoti {...}. Jeni dakord.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Atëherë do të hedhim në një enë dy grupet e çështjeve, 1-shi, 2-shi bashkë, 3-shi, 4-a, 5-a bashkë. Do të hedhim edhe emrat e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, që janë {...} dhe {...}.

Do të përzgjedhim njërin nga grupet e çështjeve. Grupi i parë i përzgjedhur është 3-shi, 4-a, 5-a. Do të përzgjedhim emrin e gjyqtarit – Është {...}.

Grupi tjetër i çështjeve është 1-shi, 2-shi, dhe është i përzgjedhur nga shorti gjyqtari {...}.

Me kaq mbarojnë edhe procedurat e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe të gjitha procedurat e shortit për mbledhjen e sotme. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Nëse nuk keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor